



Gjithë përfshirja në arsim

A jeni ju një prindër ?

*A do te kishit dëshiruar të mund të flisni me të tjerët që janë/ apo nuk janë në situatë të ngjashme si ju?
Ju lutemi bashkohuni me ne për të bërë ndryshime në gjithë përfshirje.*



Të Drejtat Themelore

- E drejta për qasje të lirë në institucione shkollore
- E drejta për shkollim
- E drejta për shërbime shëndetësore
- E drejta për mirëqenie sociale



E drejta për të qenë i barabartë

Prindërit dhe mësuesit mund të shërbejnë për shumë qëllime, mirëpo më e rëndësishmja është të njohurit dhe të kuptuarit me të tjerët dhe ndërtimi i ndjenjës së të kuptuarit në komunitet.

Prandaj, bashkohu me ne në një diskutim të hapur, pa paragjykime, në një hapësirë të sigurt dhe mikpritëse në shkollë, ku ne do të diskutojmë dhe ndihmojmë njeri tjetrin për ti dhënë kuptim gjithë përfshirjes.

Shumë nxënës, edukatorë dhe administratorë kanë njohuri të kufizuara se si t'i lehtësojnë mësimet për nxënësit me nevoja të veçanta, se si t'i përfshijmë ata në shkollë dhe në shoqëri.



Ne do të iu prezantojmë dhe do të diskutojmë me ju se çfarë është aftësia e kufizuar?

- Gjendja e cila mund të kufizojë një person për të ndërmarrë apo për të kryer një detyrë në të njëjtën mënyrë sikur një person i cili nuk ka një aftësi të kufizuar.
- Aftësia e kufizuar është edhe për shkak të mjediseve infrastrukturore të paarritshme (pa qasje) dhe qëndrimeve diskriminuese nga individët dhe shoqëria.

Si çdo fëmijë që është i rëndësishëm, çdo fëmijë ka të drejtë për një fillim të mirë në jetë, çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i përfshirë, dhe kjo është po aq e rëndësishme edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përfitimet e përfshirjes - aftësia e kufizuar nuk do të thotë përjashtim

- Bashkëjetesa me kolegët nga të cilët mund të mësojnë shkathtësi të reja nga jeta e përditshme, reale dhe shoqërore që do t'i pajisin ata që të jetojnë në komunitetet e tyre.
- Ata do të kenë mundësi të zhvillojnë miqësi me fëmijët tjerë në mënyrë të zakonshme.
- Ata do të duhej të kenë qasje në shkollim në komunitetet e tyre dhe jo të dërgohen në shkolla speciale apo të qëndrojnë në shtëpi.
- Secili në shkollë mund të zhvilloj qëndrime pozitive ndaj atyre që janë të ndryshëm nga ata.
- Ata mund të mësojnë nga të tjerët të cilët kanë arritur suksese, pavarësisht sfidave.
- Ky projekt mbështetet financiarisht nga GIZ/CDBE
- Nga gjithë përfshirja mund të përfitojnë të dytë, edhe nxënësit e ngadaltë dhe të talentuar.